Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Nr: 02-3576/6
20.10.2026
Shkup

PROCEVERBAL
nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele të mbajtur me datë 05.10.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Sasho Stefanovski, mr.Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Viktor Pavllovski dhe mr.Gordana Majnova.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski**.**

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: dr. Ivana Stojanovska, Magdalena Davidovska- Dovleva, Ivona Mufisheva, mr. Argjend Xhelili, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 33-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur me datë 22.09.2026.
2. Propozim–vendim për zgjedhjen e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Kanal 5 ShPKNjP Shkup.
4. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Koha Mevaip ShPKNjP Tetovë.
5. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimi me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike – Furnizim i 2 (dy) karrigeve ergonomike dhe 1 (një) tavolinë e vogël zyre.
1. Të ndryshme

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 22.09.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Kryetarja e Komisionit për vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara pas shpalljes së konkursit publik për zgjedhjen e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Zirjeta Jajaga, informoi se kandidati Muhamer Beqiri i plotëson të gjitha kushtet ligjore për zgjedhjen e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë. Ajo theksoi se Raporti i plotë i Komisionit për vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara pas shpalljes së konkursit publik për zgjedhjen e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë iu dorëzua të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Duke iu përgjigjur pyetjes së Kryetarit të Këshillit, Sasho Stefanovski, nëse në konkursin publik është dorëzuar vetëm një aplikim, znj. Jajaga konfirmoi se ka aplikuar vetëm një kandidat, pra Muhamer Beqiri, për të cilin Komisioni vlerësoi se i plotëson të gjitha kushtet ligjore për zgjedhjen e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë. Në bazë të vlerësimit të kryer dhe konstatimit për përmbushjen e kushteve ligjore, Komisioni propozoi që Muhamer Beqiri të zgjidhet për zëvendës i drejtorit të Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë, në pajtim me Raportin e Komisionit për vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara nga kandidatët pas shpalljes së konkursit publik për zgjedhjen e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.ark.04-3400/3 të datës 02.10.2026, njëzëri miratoi Vendim për zgjedhjen e Muhamer Beqirit si zëvendës i drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Mandati i zëvendësit të drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele është 5 (pesë) vjet.

Zëvendësi i drejtorit të Agjencisë do të jetë i angazhuar profesionalisht në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele me orar të plotë pune, duke filluar nga data 09.10.2026.

Pika 3 dhe 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi se pikat 3 dhe 4 i referohen procedurave për vazhdimin e lejeve të transmetuesve me veprimtari radiodifuzive, në pajtim me procedurën ligjore sipas së cilës, gjashtë muaj para skadimit të periudhës për të cilën është lëshuar leja, transmetuesi mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e lejes. Ai informoi se në rastin e dy transmetuesve, ShTR Kanal 5 ShPKNJP Shkup dhe ShTR TV Koha Mevaip ShPKNjP Tetovë, janë përmbushur kushtet ligjore për vazhdimin e lejes për transmetim për periudhë prej 9 (nëntë) vitesh, duke filluar nga 5 janar 2027.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Kanal 5 ShPKNjP Shkup.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, do ta publikojë Vendimin e lartpërmendur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR TV Koha Mevaip ShPKNjP Tetovë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, do ta publikojë Vendimin e lartpërmendur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 5

Mr. Ivona Mufisheva – ndihmëse udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, informoi se për rregullimin e zyrës së Kryetarit të Këshillit, është e nevojshme të blihen pajisje pikërisht 2 (dy) karrige ergonomike dhe 1 (një) tavolinë e vogël zyre. Për këtë qëllim, nga Sektori i mbështetjes së informacionit dhe çështjeve të përgjithshme është paraqitur një kërkesë e brendshme për miratimin e mjeteve. Ajo shpjegoi se për furnizimin do të zbatohet procedura për furnizim publik të mallrave, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike. Bazuar nga sa më sipër, Mufisheva propozoi që Këshilli të japë miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik të mallrave – 2 (dy) karrige ergonomike dhe 1 (një) tavolinë e vogël zyre, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike nga ku mjetet sigurohen në pajtim me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2026.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: 2 (dy) karrige ergonomike dhe 1 (një) tavolinë e vogël zyre për nevojat e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.

Pika 6

Nuk kishte diskutim nën “Të ndryshme”.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski